

Nr. Prot. Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

Nr. Dok. 202300195/2

**Lënda:** *Rekomandohet përmirësimi i menjëhershëm i kushteve të trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve në Institutin e të Miturve Kavajë.*

**Drejtuar:** **Znj. Marinela ALIAJ**  
**Drejtor i Institutit të të Miturve**

**KAVAJË**

**Për dijeni:** **Z. Admir ABRIJA**  
**Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve**

**TIRANË**

Të nderuar zotërinj,

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtërues, në vijim Mekanizmi Kombëtar (MKPT), seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar dhe në nenin 81 të ligjit nr.81/2020, datë 25.06.2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", kreu një inspektim në Institutin e të Miturve Kavajë, më datë 15.02.2023, sipas planit të inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Në përbërje të grupit inspektues ishin z. Hazbi Selita dhe z. Besnik Deda, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i kushteve të Institutit të të Miturve në Kavajë, garantimi i sigurisë, jetës, shëndetit dhe krijimi i ambienteve rekreative me qëllim rehabilitimin dhe ri-integrimin e personave që vuajnë dënimin, trajtimi dhe respektimi i të drejtave të të miturve të përcaktuara në aktet ligjore, nënligjore dhe aktet ndërkombëtare për këtë qëllim, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit të bëra gjatë inspektimeve të mëparshme.

Gjatë vizitës monitoruese, grupit të inspektimit ju ofrua mundësia që të kishin akses të plotë në këqyrjen dhe administrimin e dokumentacionit të kërkuar, inspektimin dhe evidentimin e kushteve ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit dhe të dënuarit në këtë institucion, si dhe zhvillimin e intervistave konfidenciale me personat e paraburgosur dhe të dënuarit e mitur, në përputhje me Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve në fuqi.

Mekanizmi Kombëtar, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues, ka të drejtën e detyrimit kushtetues dhe ligjor t'ju parashtrijë gjetjet e këtij inspektimi dhe të bëjë rekomandimet përkatëse.

### **Shënime të përgjithshme**

Inspektimi i MKPT-së në Institutin e të Miturve Kavajë u krye pa paralajmërim dhe pa mbikëqyrjen e stafit të institucionit gjatë zhvillimit të intervistave konfidenciale me të burgosurit, si dhe në përputhje me procedurat e parashikuara në Rregulloren e Përgjithshme të Burgjeve.

Grupi i inspektimit bazuar në metodologjinë e inspektimit në burgje, zhvilloi paraprakisht një takim me drejtuesen e institucionit znj. Marinela Aliaj, e cila u njoh me qëllimin e inspektimit.

Në takim, drejtuesja e institucionit informoi grupin e inspektimit për situatën e popullimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve të mitur në institucion, gjendjen e kushteve në të cilën ndodhen ambientet e dhomave dhe atyre të përbashkëta në regjimin e brendshëm, ku mbahen dhe trajtohen të paraburgosurit dhe të dënuarit, masat e marra nga secili prej sektorve dhe shërbimi i sigurisë së institucionit për garantimin dhe mbrojtjen e të drejtave ligjore të të paraburgosurve dhe të dënuarve në këto ambiente, mënyrën e funksionimit të sistemit të trajtimit dhe zgjidhjes së kërkesë/ ankesave, gjendjen shëndetësore dhe psiko-sociale të të paraburgosurve dhe të dënuarve, si dhe masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të Institutit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm.

Nisur nga infrastruktura e godinave në regjimin e brendshëm, elementët e sigurisë, cilësia e shërbimeve që ofrohen, si dhe ambientet e jashtme që shërbejnë për ajrim dhe aktivitete të përbashkëta, theksojmë se Instituti i të Miturve Kavajë pjesërisht garanton standarde të pranueshme për sa i përket kushteve infrastrukturore për të paraburgosurit dhe të dënuarit e mitur.

Sipas informacionit, Instituti i të Miturve Kavajë, bazuar në urdhrin e Ministrit të Drejtësisë nr.702, datë 29.12.2022 "Për disa ndryshime në urdhrin nr.8927/1, datë 27.09.2018 të Ministrit të Drejtësisë: *Për kategorizimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë*", klasifikohet si "institucion i veçantë me një seksion burgimi, një seksion paraburgimi, një seksion për persona që konsiderohen bashkëpuntor të drejtësisë, sipas ligjit nr. 10173, datë 22.10.2009 "Për mbrojtjen e dëshmitarve dhe bashkëpunëtorve të drejtësisë" i ndryshuar, një seksion i sigurisë së ulët për të rinjtë e moshës 18-21 vjeç dhe një seksion i sigurisë së zakonshme për të rinjtë e moshës 18-21 vjeç.

Kapaciteti fizik i institucionit ishte për mbajtjen, akomodimin dhe garantimin e kushteve për trajtimin dinjitoz të 40 personave. Në ditën e inspektimit, në ambientet e regjimit të brendshëm ndodheshin 20 persona të mitur në konflikt me ligjin, nga të cilët 15 të paraburgosur dhe 5 të dënuar, të cilët ishin akomoduar sipas sipërfaqeve të dhomave të banimit.

Gjithashtu, sipas statistikave, situata e popullimit për periudhën 6 mujore, rezulton si më poshtë vijon:

- Muaji shtator 17 persona
- Muaji tetor 15 persona
- Muaji nëntor 16 persona
- Muaji dhjetor 16 persona
- Muaji janar 18 persona

- Muaji shkurt 20 persona

Gjatë inspektimit të kushteve në dhomat e banimit, u konstatua se nuk çënohej e drejta për hapësirë dhe sipërfaqe jetike për person. Dhomat ishin të destinuara për qëndrimin e 1 deri në 2 personave, sipas sipërfaqes së tyre dhe ishin të gjitha të pajisura me shtretër, materiale për fjetje, si dhe me orenditë e nevojshme për mbajtjen e sendeve personale dhe të ushqimeve. Godina në regjimin e brendshëm dhe infrastruktura e institucionit ishin të përshtatura për të përballuar kapacitetin maksimal, si dhe dinamikën e lëvizjeve të të paraburgosurve dhe të dënuarve, që ndryshonte pothuajse çdo ditë.

Organika e miratuar për Institutin e të Miturve Kavajë përbëhej nga 80 punonjës, nga të cilët 32 ishin punonjës civil dhe 48 ishin punonjës me uniformë të sektorit të shërbimit të sigurisë së institucionit. Aktualisht, organika e Institutit të të Miturve Kavajë përbëhej nga sektori ligjor, sektori i çështjeve shoqërore, sektori i financës dhe buxhetit, sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve, sektori i shërbimit të kujdesit shëndetësor dhe sektori i policisë. Në tërësi, organika ishte e plotësuar, por kishte mungesa në sektorin e burimeve njerëzore dhe shërbimeve, si dhe në sektorin shëndetësor. Sektori i burimeve njerëzore dhe shërbimeve përbëhej nga 1 (një) përgjegjës sektori, 1 (një) specialist i burimeve njerëzore, 3 (tre) kuzhinierë, nga të cilët 2 (dy) kuzhinierë me kohë të plotë dhe 1 (një) kuzhiner part-time, si dhe 4 (katër) punonjës teknik të mesëm të specialiteteve të ndryshme me kohë të plotë. Sa i përket sektorit shëndetësor, ai përbëhej nga 1 (një) mjek i përgjithshëm part-time, 4 (katër) ndihmës mjekë me kohë të plotë dhe 1 (një) stomatolog me kohë të plotë, si dhe 1 (një) farmacist, i cili mungonte.

Mungesat e konstatuara në organikë, kryesisht të mjekut part-time, farmacistit, si dhe të kuzhinierit me kohë të pjesshme, në vlerësimin e MKPT-së përbëjnë problem shqetësues për garantimin e sigurisë dhe shëndetin e të burgosurve. Ndaj është urgjente, që nga DPB-ja të përshpejtohen procedurat e rekrutimit të punonjësve civil, sipas detyrave funksionale, me qëllim garantimin e kushteve për trajtimin me dinjitet të të paraburgosurve dhe të dënuarve të mitur, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të tyre që synojnë rehabilitimin për ri-integrimin e tyre në jetën familjare, shoqërore dhe ekonomike. Farmacisti ka një rol të veçantë në përcaktimin e praktikave të ruajtjes dhe shpërndarjes së mirë të barnave, si dhe kontrollin e “datave të skadencës”, të shkruar në etiketën e paketimit individual të ilaçeve dhe që përfshin kohën gjatë së cilës ilaçi qëndron sipas specifikimeve të nxjerra dhe ruajtjen e tyre në ambiente të përshtashme.

Sa i takon plotësimin të rekomandimeve të Institucionit të Avokatit të Popullit nga inspektimi i datës 26.12.2021<sup>1</sup>, nga informacioni dhe evidentimi në vend i kushteve ku mbahen dhe trajtohen të dënuarit dhe të paraburgosurit, si dhe nga intervistat konfidenciale të zhvilluara me grupe e individë në këtë institucion, rezultoi se:

1. Ishte zbatuar rekomandimi, për ndërgjegjësimin e Drejtuesit të Institutit të të Miturve, Kavajë për një qasje më proaktive në mbrojtjen dhe kujdesin ndaj të miturve, si dhe rritjen e frymës së bashkëpunimit me institucionet e mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe atyre të të miturve në veçanti.
2. Ishte zbatuar rekomandimi, për këshillime të vazhdueshme për fillimin e ecuresë disiplinore, për ata punonjës të Policisë së Burgjeve, të cilët ushtrojnë dhunë psikologjike dhe kanë komunikim jo etik me të miturit.

<sup>1</sup> Dërguar rekomandimi “Për përmirësimin e kushteve dhe të trajtimit të të dënuarve dhe të paraburgosurve në Institutin e të Miturve Kavajë”.

3. Ishte zbatuar rekomandimi, për rritjen e sasisë/kuotës së ushqimit për të miturit dhe larmishmërinë e tij<sup>2</sup>.
4. Ishte zbatuar rekomandimi, për pajisjen e institucionit me një frigorifer, i cili është i nevojshëm për ruajtjen e ushqimeve të sjella nga familjarët për të miturit.
5. Ishte zbatuar pjesërisht rekomandimi, për sigurimin e ngrohjes së vazhdueshme në të gjitha mjediset e Institutit të të Miturve Kavajë, por kërkohen më shumë orare për ngrohje, nga 6 orë në 10 orë në ditë.
6. Ishte zbatuar rekomandimi, për mbajtjen e kampioneve të ushqimit të konservuar konform rregullave.
7. Ishte zbatuar rekomandimi, për pajisjen e institucionit me një kompjuter, për të mundësuar komunikimin pa pengesa të të miturve me familjarët, si dhe gjetjen e mundësisë për të siguruar dhe një televizor.

Ndërkohë, disa nga rekomandimet ende nuk kishin gjetur zbatim dhe konkretisht<sup>3</sup>:

1. Nuk ishte zbatuar rekomandimi nga Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për krijimin e mjediseve infrastrukturore të përshtatshme e në përputhje me nevojat e të miturve, me qëllim garantimin e ndërhyrjeve të domosdoshme për riparimin dhe eliminimin e lagështirës në ambientet e Institutit të të Miturve Kavajë, situatë e cila ndikon seriozisht në shëndetin e të miturve.
2. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për ndryshimin e rregullores për të adresuar nevojat e të miturve, në një qasje tjetër të ndryshme nga të burgosurit e tjerë, rekomandim i cili ishte adresuar për miratim në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.
3. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për plotësimin e vakancës së mjekut me kohë të plotë në Institutin e të Miturve Kavajë, rekomandim i cili është përsëritur vazhdimisht.
4. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për pajisjen e ambienteve të ajrimit me tenda, të cilat ju përshtaten kushteve klimatike dhe mundësojnë ajrimin e të miturve në ditë me shi.

Gjetjet dhe rekomandimet e këtij inspektimi kanë për qëllim të vënë theksin në nevojën për të rritur bashkëpunimin ndërinstitucional në adresimin e nevojave të fëmijëve në konflikt me ligjin, përmirësimin e shërbimeve sociale ekzistuese, ngritjen e programeve të dedikuara për ri-integrimin dhe fuqizimin e të rinjve, si dhe kushte më të mira jetese duke plotësuar standardet ligjore të parashikuara në aktet kombëtare dhe ato ndërkombëtare.

Ky institucion është inspektuar në vijim nga Institucioni i Avokatit të Popullit, në rolin e tij si MKPT dhe në rolin e tij si mbrojtës i të drejtave të fëmijëve nëpërmjet SMDF, duke bërë dhe rekomandimet përkatëse.

Mekanizmi Kombëtar përgjatë inspektimit në Institutin e të Miturve Kavajë, si dhe nga gjenerimi i informacionit të administruar, sjell në vëmendje, se nisur nga rrethanat dhe nevojat e institucioneve të privimit të lirisë, në disa elementë evidentohen probleme me plotësimin korrekt të standardeve për interesin më të lartë të fëmijës, por edhe në kuptimin e zbatimit të legjislacionit penal në këtë fushë.

<sup>2</sup> Udhëzimi i përbashkët i Ministrisë të Drejtësisë me numër 1126 prot, datë 22.02.2022 dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me numër 995/1 prot, datë 07.03.2022 “Për miratimin e normës ushqimore ditore për të burgosurit”.

<sup>3</sup> Përgjigje nga Ministria e Drejtësisë me shkresën nr.6701 prot datë 17.01.2022, Lënda : Lidhur me rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit për përmirësimin e menjëhershëm të kushteve të trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve në Institutin e të Miturve Kavajë.

Në përfundim, grupi i inspektimit administroi gjithashtu kopje të dokumentacionit të disa praktikave sipas sektorëve, konkretisht:

- Organikën e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale për të Miturit Kavajë.
- Kërkesën e të burgosurve për punësim.
- Organikën e punës për të burgosurit.
- Informacion mbi gjendjen shëndetësore të të miturve.
- Kërkesën drejtuar DBP për investime.
- Planin e punës së përgjegjësit të sektorit të çështjeve shoqërore.
- Analizën vjetore nga sektori i çështjeve shoqërore.
- Kopjen e dosjes së pritjes së të burgosurit.
- Regjistrin e kërkesë/ ankesave.
- Librin e pritjes së të dënuarve.
- Raportin mujor mbi aktivitetin e sektorit të çështjeve shoqërore.
- Udhëzimin e Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale.
- Urdhrin e Ministrit të Drejtësisë për klasifikimin e institucionit.

### **Trajtimi**

Grupi i inspektimit të MKPT-së u informua nga drejtuesit e institucionit, por zhvilloi edhe intervista konfidenciale me të burgosurit, në lidhje me trajtimin e tyre nga stafi i institucionit, me qëllim identifikimin e rasteve të dhunës, përdorimin e forcës fizike tej kufijve të parashikuar në aktet normative apo ushtrimit të presionit psikologjik ndaj kësaj kategorie.

Nga intervistat e zhvilluara me të dënuarit, grupi i inspektimit nuk evidentoi raste apo pretendime për keqtrajtime dhe tejkallim të forcës fizike nga punonjësit e sigurisë të këtij institucioni. Sikurse ata pohuan në këto intervista, marrëdhëniet e stafit me të burgosurit janë të mira dhe korrekte.

Grupi i inspektimit, verifikoi edhe plotësimin e kushteve materiale të jetesës të të dënuarve dhe të paraburgosurve në këtë institucion. Inspektimi u përqëndrua kryesisht tek kushtet e banimit, higjiena personale, kushtet sanitare, veshjet, cilësia e përgatitjes dhe shpërndarjes në kohë e ushqimit, ndriçimi, ventilimi, ngrohja, ambientet e takimit me familjarët, komunikimi telefonik dhe monitorimi me kamera i ambienteve të përcaktuara sipas skemës së sigurisë.

Theksojmë se, infrastruktura në regjimin e brendshëm të institucionit ishte e plotë dhe funksionale, e cila mundësonte jetesë normale dhe llojshmëri të zhvillimit të aktiviteteve me të burgosurit. Godinat, dhomat e banimit dhe ambientet e përbashkëta në regjimin e brendshëm, ishin në gjendje të mirë teknike.

Në godinën e I EVP-së ishte **evidente lagështira, kryesisht më e theksuar në ambientin e tualeteve në këtë institucion.** Niveli i lagështirës ishte tej normave të lejuara dhe për pasojë prezencja e saj në këto ambiente ndikon drejtëpërdrejt në jetën dhe shëndetin e të të paraburgosurve dhe të dënuarve, si dhe për vetë punonjësit e policisë së burgut.

Sipas informacionit të drejtuesve të institucionit, si dhe nga intervistat me të burgosurit, kjo situatë vazhdon të qëndrojë për shkak të mungesës së hidroizolimit të plotë të tarracës së godinave të banimit. Për shkak të problematikës së përhershme me lagështirën, ambienti në tërësi lyhej më shpesh dhe bëheshin riparime të herë pas hershme.

Drejtuesja e Institutit të të Miturve Kavajë, na informoi se janë në proces të hapjes së seksionit të zakonshëm për grup moshën 18-21 vjeç, në zbatim të urdhrit të Ministrit të Drejtësisë nr.702, datë 29.12.2022 "Për disa ndryshime në urdhrin nr.8927/1, datë 27.09.2018 "*Për kategorizimin e Institucioneve të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kavajë*". Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson hapjen e seksionit të zakonshëm për grupmoshat 18-21 vjeç dhe akomodimin e tyre në dhoma të veçanta, sikurse parashikohet në manualet e sigurisë për këta persona, pasi kjo do të sjellë përmirësimin e cilësisë së jetës, mundësinë e zhvillimit të tyre dhe përkujdesjen efektive të personalitetit dhe shëndetit të të miturve në Institucionin e Privimit të Lirisë.

Në vijim, të dënuarit dhe të paraburgosurit nuk ngritën pretendime për aktivitetet me karakter edukativ dhe social të përbashkët, si leximi dhe pjesëmarrja në aktivitete që zhvillojnë mendjen dhe shprehjen në të folur, këshillimet individuale, aktivitetet fetare, të cilat zhvilloheshin rregullisht sipas planit të punës, si dhe aktivitetet sportive me të burgosurit në fushën e sportit, të krijuara sipas një marrëveshjeje midis IM Kavajë dhe Federatës Shqiptare të Futbollit dhe aktivitetet festive të organizuara nga OJF në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve.

Të paraburgosurit dhe të dënuarit u shprehen të kënaqur me shërbimin shëndetësor dhe gatishmërinë e stafit mjekësor, në përgjigje të kërkesave për ndihmë mjekësore, si në rastet e urgjencës, ashtu dhe në përmbushjen e kërkesave për konsulta të specializuara.

Mekanizmi Kombëtar vlerëson se nisur nga fakti që mjeku është i pranishëm në këtë institucion me orar të reduktuar gjatë ditës, mungesa e tij me kohë të plotë shkakton në mënyrë të drejtpërdrejtë shkeljen e së drejtës për qasje deri te mjeku nga ana e personave të dënuar apo të paraburgosur, e cila është evidentuar edhe në qëndrimet e CPT-së për këtë çështje, ku parashikohet se: "*Derisa qëndrojnë në burg, personave të dënuar duhet tu mundësohet qasja deri te mjeku në çdo kohë, pa marrë parasysh faktin e regjimit të burgosjes së tyre*" dhe se "*shërbimi shëndetësor duhet të organizohet në atë mënyrë, që do të mundësojë që kërkesat për konsultime mjekësore të ofrohen pa zgjatje të pa nevojshme*".

Në vijim, të dënuarit dhe të paraburgosurit e intervistuar, pohuan se mund të flisnin sa herë të dëshironin me të afërmit e tyre sipas Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, nëpërmjet telefonave me kartë që ishin të instaluar në korridoret e secilit prej seksioneve në regjimin e brendshëm dhe ishin në gjendje pune.

Takimet dhe shërbimet e tjera ofroheshin në mënyrë të drejtë për të gjithë. Kur prej të burgosurit kërkoheshin takime shtesë me familjarët, ato rezultojnë të mundësuar në çdo rast. Takimet zhvilloheshin në rregull sipas planifikimeve, 4 herë në muaj, sipas urdhrit nr.372, datë 11.6.2021 të Ministrisë së Drejtësisë, në një ambient me dy poste, pa kufizime, të pajisur me një tavolinë dhe disa karrige në kushte të mira.

Një shqetësim i ngritur nga drejtuesja e institucionit ishte formimi i klasave arsimore në institucion për të miturit në konflikt me ligjin me 10 nxënës. Kjo gjë ishte e pamundur në institucion, pasi varet nga dinamika e lëvizjes së të miturve në konflikt me ligjin. Këtë shqetësim drejtuesja e institucionit e ka ngritur në mënyrë të vazhdueshme në institucionet përgjegjëse, në lidhje me formimin e klasave të të miturve në konflikt me ligjin sipas udhëzimit të Ministrisë të Arsimit, **ku thuhet ndër të tjerat se: "Një klasë krijohet kur numri i nxënësve në klasat VI-IX është deri në 10 nxënës"**<sup>4</sup>. Për këtë situatë nga ana e Ministrisë së Arsimit nuk ka një përgjigje

<sup>4</sup> <https://www.portalishkollor.al/kuriozitet/arsimi-baze-numri-i-nxenesve-dhe-norma-e-mesuesit>.

në lidhje me zgjidhjen e shqetësimit të ngritur nga ana e drejtueses së institucionit në lidhje me ofrimin e arsimit për të dënuarit dhe të paraburgosurit në Institutin e të Miturve Kavajë.

Përsa më lart, Institucioni i Avokatit të Popullit kërkon nga Ministria e Arsimit dhe Sportit: *“Rishikimin e udhëzimit për formimin e klasave shkollore në 10 nxënës”*, pasi ky udhëzim kufizon të drejtën e të miturit në konflikt me ligjin për tu arsimuar. Po ashtu, vlerësojmë se procesi mësimor për të miturit e vendosur në mjediset e Institutit të të Miturve Kavajë është në përputhje me standardet e shërbimit të arsimit në Republikën e Shqipërisë të përcaktuar nga Kushtetuta dhe legjislacioni në fuqi. Çdo i mitur që ndodhet në mjediset e Institucionit të Privimit të Lirisë ka të drejtë të arsimohet në përshtatje me nevojat dhe aftësitë e tij duke u bazuar në programe dhe plane mësimore në përshtatje me nevojat dhe aftësitë e tij që synojnë ri-integrimin dhe aftësimin për të marrë një rol konstruktiv në shoqëri pas liritimit.

Në Institutin e të Miturve Kavajë ishin të punësuar 6 të burgosur, të cilët punonin 4 orë në ditë, sipas strukturës organike, në pozicione pune si sanitarë, ndihmës kuzhiner, shpërndarës ushqimi, bojaxhi, lavaxhi, lulishtar, berber etj. Sipas intervistave me të burgosurve, punësimi paraqet interesim për sa kohë që kushtet e punësimit dhe shpërblimi janë të rregulluar me aktet nënligjore, sikurse parashikohet në nenet 43 dhe 44 të ligjit nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*, të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, miratuar me VKM-në nr. 209, datë 06.04.2022, si dhe VKM-në nr.602, datë 13.10.2021 *“Për përcaktimin e rregullave të posaçme për punësimin e të burgosurve, kushtet e punës, kohëzgjatjen dhe shpërblimin e saj”*; të urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr. 169, datë 16.05.2022 *“Për lidhjen e kontratës së punës me të burgosurit e punësuar për nevoja shërbimi në IEVP dhe pagesat e tyre”*. Të burgosurve u krijohet mundësia për punësimin në kuadër të garantimit të fitimit, ruajtjes dhe zhvillimit të aftësive për punë dhe njohurive profesionale, për ri-integrimin në shoqëri pas përfundimit të kryerjes së dënimit.

## **Masat mbrojtëse**

Një objektiv i inspektimit ishte verifikimi i funksionimit të sistemit të kërkesë/ankesave të të burgosurve për trajtimin e korrespondencave të tyre brenda institucionit dhe me institucionet e tjera qendrore.

Nga informacioni i drejtuesve të institucionit, intervistat e zhvilluara me të burgosurit, si dhe nga kontrolli i regjistrave, rezultoi se, sistemi i kërkesë/ankesave funksiononte sipas kërkesave të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve dhe urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve<sup>5</sup>.

Në urdhër përcaktohej se, specialistët e sektorit të çështjeve shoqërore ishin personat përgjegjës të autorizuar, të cilët në mënyrë periodike merrnin kërkesë/ankesat e të dënuarve/paraburgosurve të mitur. Në vijim, ata kryenin regjistrimin e tyre në regjistrin përkatës që mbahej në sektorin e protokoll-arshivës së institucionit dhe i dërgonin ato te drejtori i institucionit. Specialistët sipas sektorve, në varësi të shënimeve të drejtuesit të institucionit, kryenin trajtimin dhe kthimin e përgjigjes brenda afatit të përcaktuar në rregulloren e institucionit<sup>6</sup>.

Nga verifikimi i regjistrit të kërkesë/ankesave, për vitin 2023 ishin regjistruar rreth 33 kërkesa nga të burgosurit. Konkretisht, kërkesa për punësim, kërkesa për sektorin ligjor, kërkesa për sektorin e policisë, kërkesa për takim me drejtorin e institucionit etj.

<sup>5</sup> Neni 58, pika 5 e ligjit Nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

<sup>6</sup> Neni 58 i ligjit Nr.81/2020 *“Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”*.

Grupi i inspektimit nuk mori ankesa në lidhje me procedurat që ndiqen nga stafi i institucionit në lidhje me trajtimin dhe zgjidhjen e kërkesave të tyre nga drejtuesit e institucionit.

Gjatë inspektimit, grupi i punës verifikoi gjithashtu procedurat e ndjekura për hyrjet e reja të të burgosurve në institucion, ngritjen dhe funksionimin e komisionit të pritjes, intervistimin e të burgosurve, evidentimin e gjendjes shëndetësore dhe psiko-sociale të tyre, si dhe mënyrën e plotësimit të regjistrit dhe dosjeve personale të të burgosurve. Nga verifikimi i këtij dokumentacioni u konstatua se, procedura e pranimit të të burgosurve që hyjnë rishtaz në institucion zbatohet në mënyrë korrekte nga komisioni i pritjes, praktikë kjo e cila ishte e evidentuar në libër dhe në regjistrin përkatës. Më tej, dokumentacioni protokollohet në sekretarinë e institucionit.

Për çdo të mitur është përgatitur një raport psikologjik dhe social, në të cilin janë identifikuar dhe përshkruar faktorët, që shërbejnë si element kyç për llojin dhe nivelin e kujdesit dhe programit që nevojitet për trajtimin e të miturit. Informacioni i marrë nga intervista dhe raporti janë elementë të rëndësishëm për vendosjen në mënyrë sa më të përshtatshme të të miturit brenda mjediseve dhe përcaktojnë nivelin e kujdesit dhe programit që duhet ndjekur për çdo të mitur. I gjithë dokumentacioni dhe veprimet e kryera, janë të administruara në dosjet individuale të të miturve. Për çdo të mitur në Institutin e të Miturve Kavajë është përgatitur një plan individual i trajtimit, duke specifikuar objektivat, periudhën kohore, mjetet, fazat dhe hapat konkret, që duhet të ndiqen për realizimin e këtyre objektivave. Nga këqyrja e dokumentacionit përkatës, konstatohet se shërbimet e kujdesit psikosocial janë në përputhje me përcaktimet e parashikuara në Kodin e Drejtësisë Penale për të Mitur<sup>7</sup>.

Në Institutin e të Miturve Kavajë, shërbimet psiko-sociale kanë qasjen e shërbimit multidisiplinor, i cili për çdo të mitur fillon menjëherë, pas pranimit në mjediset e burgimit ose të paraburgimit. Nga vlerësimi i dosjeve psiko-sociale, çdo i mitur është intervistuar brenda 24 orëve, nga momenti i pranimit në mjediset e Institutit të të Miturve Kavajë.

Ambientet e institucionit monitoroheshin me kamera 24 orë. Sistemi i monitorimit me kamera ka gjithsej 46 kamera të jashtme dhe 25 kamera të brendshme. Njëra nga DVR, ajo e cila ka 16 kamera, mban 21 ditë pamje filmike të regjistruara, kurse DVR-ja tjetër ku janë të instaluar 30 kamera, mban regjistrimin 12 ditë.

Theksojmë se, mbikëqyrja me kamera e të gjithë mjediseve në një IEVP, përveç atyre mjediseve ku çenohet privatësia, është vlerësuar nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit, si një proces thelbësor për tre arsye:

**Së pari**, mbikëqyrja me kamera ka një efekt parandalues për veprime të kundërligjshme që mund të kryhen, si nga ana e të dënuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së burgjeve.

**Së dyti**, mbikëqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të burgjeve dhe paraburgime, si dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm për masat disiplinore, apo penale që duhet të merren ndaj individëve përgjegjës.

**Së treti**, dokumentimi filmik është një material mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe të paanshme në rekomandimet apo raportet përkatëse që harton vetë Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, si dhe institucionet monitoruese të pavarura.

---

<sup>7</sup> Neni 115, i ligjit nr.37/2017 “Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur”



Nga inspektimi në ambientet e regjimit të Institutit të të Miturve Kavajë, grupi i inspektimit konstatoi se në korridore ishin të afishuara posterat me të drejtat e personave të shoqëruar, por ato kishin nevojë të rifreskohen me të reja. Gjithashtu, afishimi i të drejtave duhet të bëhet edhe në vende të tjera të aksesueshme nga personat që ndodhen në mjediset e IEVP-së, me qëllim për të dhënë mundësinë e leximit dhe kuptimit të këtyre të drejtave nga ana e tyre.

## **Kushtet materiale**

Grupi i inspektimit verifikoi edhe kushtet materiale, të cilat janë të rëndësishme për respektimin e standardeve normale të jetesës. Instituti i të Miturve Kavajë funksionon që prej vitit 2009 si qendër rehabilitimi, këshillimi dhe shkolle për të miturit e moshës 14-18 vjeç. Kapaciteti i institucionit është 40 persona dhe institucioni ishte i ndarë në 4 (katër) sektorë, nga të cilët 3 (tre) sektorë shërbejnë për të paraburgosurit dhe 1 (një) sektor për të dënuarit.

Problematikat e vërejtura konsistojnë në prezencën e lagështirës në disa sektorë, por edhe pse ishte bërë një investim rreth 4.000.000 lekë, sërish vërehej lagështira në korridoret e institucionit, në klasat ku zhvillohej mësim, si dhe në palestër. Nga ana e institucionit ishin dërguar kërkesat me nevojat për investime drejtuar DPB, por ende nuk ishin siguruar fonde nga buxheti i shtetit për hidroizolim të tarracave të godinave.

Gjatë verifikimit të kryer nga grupi monitorues, si dhe nga intervista e realizuar me përgjegjës të shërbimit ligjor dhe me përgjegjës të çështjeve sociale, hapësirat e qëndrimit dhe të fjetjes ishin të mjaftueshme. Çdo sektor ishte me 5 dhoma banimi me kapacitet për 2 banorë dhe secila prej dhomave ishte e pajisur me tualet brenda saj.

Baza materiale për akomodimin e të burgosurve dhe për jetesë normale ishte e plotësuar. Në çdo dhomë banimi kishte shtretër, dyshekë, batanije e jastëkë dhe nga inspektimi nuk rezultoi të kishte asnjë person që flinte me dyshekë në tokë. Nga intervistat me të burgosurit, u evidentua fakti se pavarësisht se baza materiale përgjithësisht ishte e plotësuar, kishte të burgosur që deklarorin se batanijet dhe çarçafët i siguronin nga familjarët e tyre. Dyshekët dhe shtretërit ishin në kushte të mira dhe niveli i higjienës ishte i kënaqshëm në të gjitha mjediset e vëzhguara.

Mjedisi i qëndrimit të përbashkët ishte i lyster dhe i pastër dhe në të ndodhej vetëm një televizor, ku të miturit kalonin shumicën e kohës.

Ambientet në regjimin e brendshëm ishin sipas standardeve përsa i përket llojshmërisë, si klasat e edukimit dhe këshillimit psiko-social në çdo sektor, dhomat për takimet me familjarët, dhomat e prindërimit në distancë, klasat ku zhvillohej mësimi, kurset profesionale, biblioteka etj.

Në Institutin e të Miturve Kavajë kishte sistem qendror ngrohjeje, i cili ishte funksional dhe vihej në punë nga ora 17:00 deri në orën 23:00, por nga intervista me të burgosurit, ata ngritën shqetësim për shtim të orëve të ngrohjes nga 6 orë në 10 orë për shkak të temperaturave të ulta që gjatë natës mund të jenë deri në nën 5 gradë celsius.

Uji i rrjedhshëm sigurohej 24 orë nga pusi, por institucioni ishte pajisur me një filtrues uji, gjë që e bënte atë të pastër dhe të pijshëm, kjo e vërtetuar edhe nga analizat për kontrollin e cilësisë së ujit. Përsa i takonte sigurimit të ujit të pijshëm, të paraburgosurit dhe të dënuarit deklarorin se atë e blinin kundrejt pagesës në njësinë e re tregtare, gjë e cila rriste shpenzimet e familjarëve të tyre.

Ambientet në regjimin e brendshëm kishin energji elektrike të pandërprerë që furnizohej nga rrjeti elektrik, por kishte dhe burim energjie rezervë me gjeneratorë, për furnizimin me energji elektrike në rast ndërprerje të energjisë.

Ambienti i dusheve ishte i përbashkët për çdo seksion dhe kishte nevojë për lyerje dhe mbajtjen pastër nga ana higjieno-sanitare. Duset ishin funksionale, por mungonin kokat e dusheve.

Në Institutin e të Miturve Kavajë, funksiononte normalisht lavanderia, ku tashmë të 3 lavatriçet dhe 1 tharëse rrobash ishin në punë dhe të paraburgosurit dhe dënuarit merrnin shërbim pa vështirësi.

Ambienti i takimeve të të burgosurve me familjarët në I EVP Kavajë, kishte 1 post për takime online, 2 poste për takime fizike me familjarët e të burgosurve dhe 1 dhomë prindërimi në distancë. Nga intervistat, rezultoi se të burgosurit zhvillonin takimet rregullisht sipas Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, si dhe takime online me familjarët e tyre, për të cilat nuk kishin ankesa në lidhje me planifikimin dhe kohëzgjatjen e orarit të takimeve.

Dhomat e prindërimit në distancë ishin të pajisura me tavolinë dhe karrige, ku të miturit mundet të takonin fizikisht prindërit e tyre. Gjatë takimeve me familjarët në këto dhoma, respektoheshin masat e sigurisë, por dhe privatësia e takimit.

Ajrimi i të miturve të paraburgosur dhe të dënuar bëhej në katër ambiente në institucion, të cilat ishin të pambuluara me tenda, duke marrë parasysh kushtet klimaterike dhe ditët me shi që pamundësojnë për të miturit të kryejnë orarin e ajrimit. Personat e paraburgosur dhe të dënuar nuk paraqitën ankesa lidhur me oraret e ajrimit, të cilat ishin konform standardeve dhe rregullores së institucionit.

Në regjimin e brendshëm ishte edhe fusha e futbollit.

Ushqimi për të dënuarit dhe të paraburgosurit gatuhej në kuzhinën e institucionit, e cila ishte me hapësirë e sipërfaqe të madhe, si dhe me ambiente më vete për gatimin e ushqimit dhe për ruajtjen e tij. Kuzhina ishte e kompletuar me pajisje frigoriferike për secilin produkt ushqimor më vete, me pajisje kuzhine alternative (elektrike dhe gaz) për gatimin e vakteve ushqimore, si dhe me karroca dhe vaska nikelato për shpërndarjen e ushqimit deri te të burgosurit, të cilat ishin të reja dhe të një cilësie shumë të mirë.

Në kuzhinë ndodhej e afishuar kuota ditore, menya, si dhe librezat shëndetësore të personelit të kuzhinës, ndërsa kampionët e ushqimit për secilin vakt ushqimor ruheshin në kushte frigoriferike. Gatimi i ushqimit kryhej sipas kategorive të përcaktuara në Rregulloren e Brendshme të Burgjeve më vete për të burgosurit, për të punësuarit, si dhe për të sëmurët kronik apo diabetik, por në momentin e kryerjes së inspektimit nuk kishte të sëmurë kronik apo diabetik. Personeli i kuzhinës përbëhej nga 3 kuzhinerë sipas strukturës organike nga të cilët 1 (një) ishte part-time dhe 2 (dy) me kohë të plotë. Në intervistat me të paraburgosurit dhe të dënuarit, nuk u paraqitën ankesa lidhur me cilësinë e gatimit, por ata kishin pretendime për larmishmërinë e tij.

## **Regjimi dhe aktivitetet**

Institucioni i të Miturve Kavajë siguron mjediset dhe mjetet e përshtatshme dhe të nevojshme, që të miturit të kryejnë arsimimin shkollor dhe profesional, veprimtaritë çlodhëse, kulturore dhe çdo veprimtari tjetër të përbashkët ose individuale që kërkojnë ata.

Veç kësaj, në institucion kishte një bibliotekë dhe botime të ndryshme. Në këto mjedise të përshtatshme (të ashtuquajtura klasa), zhvillohet procesi mësimor për arsimin e detyrueshëm 9-vjeçar, nga klasa e parë deri në klasën e nëntë, për 7 të mitur dhe arsimit mesëm i përgjithshëm, për 10 të mitur. Mësuesit vinin nga shkolla 9-vjeçare “Rilindja” dhe shkolla e mesme e përgjithshme “11 Shkurti” e qytetit të Kavajës, sipas marrëveshjes, ndërmjet Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe Ministrit të Drejtësisë. Provimet e lirimimit nxënësit i jepnin në shkollë publike në qytetin e Kavajës. Ndërsa, gjatë inspektimit konstatuam, se kurset e formimit profesional zhvilloheshin rregullisht sipas formimeve profesionale; saldator, hidraulik, elektrikist.

Numri i të miturve që kanë shfaqur interes dhe kërkesë regjistrimi në kurset e formimit profesional gjatë muajit janar dhe shkurt 2023 është 15 të mitur dhe konkretisht:

- 6 të mitur për kurs për hidraulik
- 6 të mitur për kurs elektrikist
- 3 të mitur për punë me dru

Avokati i Popullit mendon se përfshirja e të miturve në këto aktivitete është të gjithë pranuar kombëtare dhe domosdoshme, për të përmirësuar jetën e të miturve në konflikt me ligjin. Sipas standardeve ndërkombëtare, shteti duhet të bëjë më shumë që të miturit në konflikt me ligjin të përfitojnë maksimalisht nga programet e rehabilitimit dhe ri-integrimit të tyre në shoqëri.

Stafi i kujdesit social ishte i plotësuar, ku në përbërje të tij kishte punonjës social dhe një psikolog. Punonjësit e këtij sektori kryenin aktivitetet sipas programit të miratuar më parë me një plan mujor.

Për sa i përket aktiviteteve rekreative në këtë institucion, nga ana e ekspertëve të Mekanizmit Kombëtar u konstatua se ato ishin të larmishme nga të cilat mund të përfitonin të dënuarit/paraburgosurit, si ndjekja e TV në dhomat e banimit ose në holle, lojërat e tavolinës, ushtrime në palestër, pingpong, futboll, etj. Gjithashtu kishte edhe një ambient për zhvillimin e aftësive në pikturë, për tu përdorur nga ata që kanë prirje në këtë fushë.

Në institucion e drejta e besimit respektohej dhe kishte hapësira të veçanta për ushtrimin e fesë, e cila realizohej në ditët e caktuara. Aktivitetet fetare ofroheshin nga komuniteti mysliman shqiptar dhe shoqata kristiane e të burgosurve shqiptar.

### **Shërbimet shëndetësore**

Grupi i inspektimit, gjatë vizitës inspektuese në Institutin e të Miturve Kavajë i kushtoi një rëndësi të veçantë funksionimit dhe cilësisë së ofrimit të shërbimit shëndetësor të të dënuarve dhe të paraburgosurve, për garantimin dhe ruajtjen e shëndetit të personave që vuajnë dënimin ose janë në pritje të dënimit në regjimin e burgjeve, si dhe krahasuar me standardet e përcaktuara në aktet ndërkombëtare për këtë qëllim. Nga intervistat me të burgosurit gjatë sesionit monitorues në këtë institucion nuk u konstatuan ankesa sa i përket shërbimit shëndetësor.

Organika e sektorit shëndetësor përbëhej nga 7 (shtatë) punonjës, prej të cilëve 1 (një) mjek me kohë part-time, 1 (një) stomatolog, 4 (katër) infermierë. Stafi shëndetësor ishte i plotësuar pjesërisht, pasi kishte mungesë në organikë me farmacist dhe një mjek i cili ishte i punësuar part-time.

Në vlerësimin e MKPT-së, kjo përbën mohim të së drejtës për të marrë shërbim mjekësor të specializuar në spitale të të burgosurve, të sëmurëve kronikë apo atyre që paraqesin shqetësime shëndetësore. Gjithashtu, kjo përbën edhe shkelje të standardit të përcaktuar në Rregulloren Evropiane të Burgjeve ku thuhet shprehimisht se: *“Autoritetet e burgut ruajnë shëndetin e të gjithë të burgosurve që janë në kujdesin e tyre. Shërbimet mjekësore në burg organizohen në bashkëpunim të ngushtë me administrimin shëndetësor të komunitetit ose të shtetit. Të burgosurit i ofrohen shërbimet mjekësore, kirurgjike dhe psikiatrike, duke përfshirë dhe ato shërbime që janë të disponueshme në komunitet”*<sup>8</sup>.

Shërbimi shëndetësor ndodhej në një godinë jashtë regjimit të brendshëm, në një ambient të veçantë ku ndodhej dhoma e vizitave të mjekut, dhoma e stomatologut, farmacia dhe dhoma për konsultat ditore dhe rastet e urgjencës. Dhoma e vizitave mjekësore ishte e pajisur me orenditë e domosdoshme dhe ishte me kushte fizike të mira. Dhoma e stomatologut ishte e rregullt, e pajisur me autoklavë dhe poltron të ri dhe funksiononte rregullisht për ofrimin e shërbimeve të nevojshme.

Farmacia ishte e rregullt dhe furnizimi me medikamente bëhej nga DPB dhe Drejtoria e ISKSH, sipas marrëveshjes tre palëshe të lidhur ndërmjet ISKSH-së, IEVP-ve dhe Depos Farmaceutike, si dhe nga fondi i veçantë për ilaçet, që nuk vinin nga dy burimet e para.

Nga këqyrja e dokumentacionit të stafit mjekësor dhe në veçanti e dokumentacionit të mjekut, rezultoi se regjistrat përkatës mbaheshin dhe plotësoheshin konform rregullave. Gjithashtu edhe kartelat mjekësore ishin plotësuar dhe mbaheshin të mbyllura në dollap me dry.

Nga këqyrja e regjistrave të vizitave mjekësore, grupi i inspektimit konstatoi se në të shumtën e rasteve diagnozat për të miturit ishin bronkit, laringit, ftohje dhe sipas mjekut faktor kryesor i këtyre simptomave ishte lagështira e theksuar në institucion<sup>9</sup>.

Gjithashtu, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve të të Miturve Kavajë, nuk ishte pajisur me ambulancë si pjesë e domosdoshme për shërbimin cilësor shëndetësor në kohë të shpejtë për të paraburgosurit dhe të dënuarit në këtë institucion.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, gërma “b” të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve” ku parashikohet midis të tjerash se: “ Në funksion të zbatimit të këtij ligji, mekanizmi kombëtar ushtron këto kompetenca:*

*b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”*.

### **REKOMANDOJMË:**

<sup>8</sup> Rregullorja Evropiane e Burgjeve, pika 39, 40.1, 40.5;

<sup>9</sup> Neni 75, Kushtet e të miturit në mjediset e paraburgimit, ligji nr. 37/2017 Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur, parashikon se: *“Gjatë kohës që i mituri mbahet në paraburgim, sipas nevojës dhe në përputhje me moshën, gjininë dhe personalitetin, i ofrohet ndihmë sociale, edukative, psikologjike, mjekësore dhe fizike”*.

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për hidroizolim të plotë të terracës së godinës në regjimin e brendshëm në Institutin e të Miturve Kavajë, për eliminimin e lagështirës në ambientet e brendshme të banimit dhe në ambientet e përbashkëta të dusheve dhe tualeteve, situatë e cila ndikon seriozisht në shëndetin e të miturve.
2. Marrjen e masave të menjëhershme, për vënien në funksion të të gjitha dusheve, si dhe lyrjen e ambienteve për të qenë sa më të pastra nga ana higjieno-sanitare.
3. Marrjen e masave të nevojshme, për plotësimin e organikës të stafit mjekësor me një mjek të përgjithshëm me kohë të plotë, farmacist dhe kuzhiner sipas organikës së miratuar, me qëllim garantimin cilësor të shërbimit shëndetësor për të burgosurit.
4. Marrjen e masave të menjëhershme, për pajisjen e institucionit me një autoambulancë për rastet emergjente të të sëmurëve dhe shoqërimin në Spitalin Rajonal Kavajë apo Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë.
5. Marrjen e masave nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për sigurimin e ngrohjes së vazhdueshme në të gjitha mjediset e Institutit të të Miturve Kavajë për të rritur numrin e orareve të ngrohjes në 10 orë sipas përshtatjes dhe me kushtet klimaterike të zonës nga 6 orë që është aktualisht.
6. Marrjen e masave të menjëhershme nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve, për rishikimin e udhëzimit për krijimin e klasave deri në 10 nxënës për IEVP-të, dhe lejimin e çdo të mituri që ndodhet në mjediset e institucionit të privimit të lirisë të ketë të drejtë të arsimohet, në përshtatje me nevojat dhe aftësitë e tij, duke u bazuar në programe dhe plane mësimore që synojnë ri-integrimin dhe aftësimin për të marrë një rol konstruktiv në shoqëri pas lirimit, sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe aktet të tjera ligjore në fuqi.
7. Marrjen e masave, për pajisjen e ambienteve të ajrimit me tenda, të cilat ju përshtaten kushteve klimatike dhe mundësojnë ajrimin e të miturve në ditë me shi.
8. Marrjen e masave të menjëhershme, për larminë e ushqimit sipas produkteve të stinës, si dhe ushtrimin e kontroleve të vazhdueshme nga drejtuesit e institucionit, për këtë problematikë.
9. Marrjen e masave të menjëhershme nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, për miratimin e Rregullores së Brendshme të Institutit të të Miturve Kavajë, duke adresuar nevojat e të miturve në një qasje tjetër të ndryshme nga të burgosurit e tjerë.
10. Marrjen e masave të menjëhershme, për afishimin në ambientin e regjimit të brendshëm të Institutit të të Miturve Kavajë dhe në ambientet e tjera të aksesueshme të posterave me të drejtat e të burgosurve në konflikt me ligjin.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**AHMET PRENÇI**